

## **“NOE” SH.P.K**

### **STATUTI**

#### **TITULLI I (EMËRTIMI – OBJEKTI – KOHËZGJATJA – SELIA )**

##### **Art. 1 – Emërtimi**

1.1 Është aktuale një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën “**NOE” SH.P.K**

##### **Art. 2 – Selia e shoqërisë dhe vendqëndrimi i ortakëve**

- 2.1 Shoqëria ka selinë zyrtare (ligjore) në Durrës, Lagjia 17, Rruga “Stefan Kaculini, Pallati “Orion Konstruksion”, zona katastrale 8515.
- 2.2 Shoqëria, sipas modaliteteve (rrugë proceduriale) ligjore, mund të krijojë filiale, agjensi, përfaqësi (zyra përfaqësimi), magazina dhe depo, degë, pika kontakti dhe zyra si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë.
- 2.3 Vendqëndrimi i ortakut te vetem, përsa i përket marrëdhënieve me shoqërinë, është ai i përcaktuar në aktin e themelimit, ose më saktë në komunikimin e fundit (shpalljen) të bërë nga shoqëria.

##### **Art. 3 – Objekti i shoqërisë**

###### **3.1 Shoqëria ka si objekt:**

Shoqëria ka si objekt ushtrimin, per llogari te vet apo per persona te trete, duke respektuar ligjet, si ne Republiken e Shqiperise ashtu edhe jashtë kufijve, te aktiviteteve te pasqyrura me poshte:

- a) Tregtim me shumice dhe pakice, import-export, marketing te produkteve kozmetike, estetike, higjenike, dietike, ushqimore, medikamente, te materialeve dhe paisjeve mjeksore dhe aksesoreve te tyre, kiteve laboratorike, te lendeve te para te perpunuara per prodhime farmaceutike, e parafarmaceutike, lendeve te gatshme apo gjysem te gatshme kozmetike, estetike dhe higjenike.
- b) Tregti me produkte/pajisje kozmetike, estetike, higjenike apo mjekesore;
- c) Hapje pika shitjesh per tregtim te produkteve estetike, kozmetike apo higjenike;
- d) Zhvillim te aktivitetit kerkimor shkencor ne Shqiperi dhe jashtë vendit.
- e) Shoqëria do te kryeje te gjitha veprimtarite e shitjes se drejtperdrejte te produkteve kozmetike dhe estetike, kremrave, locioneve, fragrancave, parfumeve dhe produkteve te tjera te bukurise produkte te modes, produkte konsumi dhe produkte shtepiake te te gjitha llojeve, artikuj argjendarie. Prodhimin, reklamimin, shperndarjen e artikujve kozmetike, estetike, higjenike, dietike dhe mjeksore;
- f) Tregti me shumicë e pakicë, import, eksport brenda dhe jashtë vendit të mallrave industrialë, elektrikë, hidrosanitare, elektroshëpiake, ushqimore, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, cigare, bujqësore, ndërtimore dhe drusore, shërbime tregtje për bar, bufë, piceri e restorant, transport mallrash të ndryshëm, brenda e jashtë vendit për vete e të tretë. Hoteleri, agjensi udhëtimësh, dhënie automjete me qera.



- g) Shoqeria, brenda kufijve ligjore, mund te kryeje cdo operacion qe lidhet me pasuri te luajteshme, te paluajteshme, truale (blerje, dhenie me qera, shitje).
- h) Shoqeria mund te kryeje Brenda kufijve ligjore aktivitete te tjera ndihmese, te ndervarura apo ne funksion te aktiviteteve te mesiperme;
- i) Shoqeria mund te marre pjesë ne menyre te drejtoperdrejte ose terthorte ne cdo shoqeri qe ka object te ngjashem apo qe lidhet me objektin e shoqerise.
- j) Shoqeria mund te kryeje dhe veprintari te tjera ndihmese te cilat mbeshtesin arritjen e sellimit te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi;
- k) Shoqeria mund te angazhohet gjithasdhdu ne cdo lloj aktiviteti tjeter qe nuk ndalohet me ligj;
- l) Blerje, shitje te aksioneve ne shoqeri te te gjitha tipeve, qe jane themeluar ose ne faze themelimi qe kane objekt social te njejtë ose te ndryshem nga objekti social i firmes perfshire ketu aktivitet e vleresimit dhe menaxhimit te ketyre te fundit;
- m) Sherbime te lidhura me asistencen teknike, menaxhuese ose te strategjive te firmave, drejtuese, tregtare dhe administrative.

3.2 Aktivite shtesë atyre themeltare në përputhje me objektin e shoqërisë.

#### **Art. 4 – Kohëzgjatja (jetëgjatësia) e shoqërisë**

4.1 Jetëgjatësia e shoqërise është e përcaktuar me afat te pakufizuar.

## **TITULLI II KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESMARRJA E ORTAKËVE**

#### **Art. 5 – Kapitali i shoqërisë , kuotat e pjesmarrjes.**

5.2 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 leke.; i cili mund të shtohet ose pakësohet me vendim të posaçëm të asamblesë së ortakëve dhe kontributet mund të bëhen në natyrë ose shkëmbime financiare. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tij te meposhtme.

5.3 Të drejtat mbi shoqërinë i përkasin ortakut

Ortaku themelues z.Gentian Nika : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te per gjithshme 100 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise. Kontributi mund te jete ne para ose ne natyrë (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

#### **Art. 6 – Tranferimi i kuotave.**

6.1 Tranferimi i pronësisë apo të drejtave te tjera reale mbi kuotat e shoqërisë është i lirë në rastin e kalimit trashëgimor.

6.2 Tranferimi i pjesmarrjes midis të gjallëve, nga ana tjetër , duhet të ndodhë vetëm në favor të ortakëve të rinj për të cilët asamblea , me shumicë të kapitalit të shoqërisë , të ketë dhënë pëlqimin e saj.

## TITULLI III VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE

### **Art. 7 – Vendimet e ortakëve**

7.1 Ortakët vendosin përmes " Asamblesë së Ortakëve " mbi cështjet e mëposhtme të cilat u janë rezervuar atyre si kompetenca:

- modifikimet e statutit;
- vendimet për të ndermarrë operacione që kanë të bëjnë me modifikimin e objektit të shoqërisë ose një modifikim të të drejtave të ortakëve;
- vendimet e lidhura me shpërndarjen e fitimeve;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- aprovimin e bilancit të periudhës ushtrimore;
- vënien në likujdim të shoqërisë;
- çdo vendim tjetër për të cilin të paktën njeri prej administratorëve të kërkojë rezolutën e Asamblesë.

7.2 Asambletë mund të mbahen edhe në audio–videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarrjes si më poshtë:

1. duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm presidenti dhe sekretari i mbledhjes.
2. Duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje;
3. duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuar si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenza reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

7.3 Në rastin kur asamblea duhet të mbahet ne audio – videokonferencë ose në audiokonferencë, në lajmërimin e thirrjes duhet të përcaktohet ora e fillimit të lidhjes telematike dhe vendet e audio – video konferencës të lidhura nën kujdesin e shoqërisë të cilëve do t'i bashkohen pjesmarrësit: në cdo vend mbledhjeje duhet të mbahet një procesverbal i pjesmarrjes.

### **Art. 8 – Efikasiteti i vendinmarrjes së asamblesë**

8.1 Asambletë e formuara dhe të thirruara rregullisht përfaqësojnë të drejtën universale të ortakëve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me aktin në fjalë i detyron të gjithë ortakët edhe ata të munguar ose kundërshtues me përjashtim të atyre që kanë përdorur të drejtën e tërheqjes sic parashikohet në ligj.

### **Art. 9 – Thirrja dhe vendi i Asamblesë**

9.1 Asambleja e ortakëve, e cila mund të mbahet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër do të thirret nga organi administrativ përmes një lajmërimi të dërguar ortakëve, këshilltarëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit, nëse ata janë emëruar të paktën tetë ditë përpërpara datës së fiksuar për mbledhjen në adresën të cilën cdo i nteresuar i ka dhënë shoqërisë.

9.2 Lajmërimi i thirrjes duhet të përbajë përshkrimin e ditës, orës dhe vendit ku do të mbahet mbledhja si edhe argumentet mbi të cilat asamblesë i kërkohet të marrë vendime.

9.3 Në të njëjtin lajmërim mund të fiksohet për një ditë tjetër një mbledhje e dytë në rast se e para nuk do kishte pjesmarrje apo nuk do të mund të formohej rregullisht.

9.4 Lajmërimi mund të redaktohet në cdo lloj forme qoftë në letër apo elektronik dhe mund të dërgohet me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë sigurohet se mund të provohet marrja e

këtij njoftimi.

### **Art. 10 – Ndërhyrja dhe përfaqësimi në asamble**

- 10.1 Mund të ndërhyjnë në asamble të gjitha ata që rezultojnë të jenë ortakë në datën e asamblesë.
- 10.2 Cdo ortak mund të përfaqësohet përmes një prokure të shkruar të dorëzuar ose me fax ose me postë elektronike nga një person tjetër i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak.
- 10.3 Prokura nuk mund të lëshohet e pashkruar.

### **Art. 11 – Presidenti i asamblesë**

- 11.1 President i asamblesë është ose administratori i vetëm ose nga presidenti i këshillit të administrimit, në rastin e emërimit nga një organ kolegjal ose në mungesë të tyre nga një person i përgjedhur nga asambleja.
- 11.2 Për të arritur tek kjo përgjedhje mbledhja duhet të drejtohet përkohësisht nga personi me moshën më të madhe i cili është i pranishëm në asamble.
- 11.3 Asambleja zgjedh sekrtarin dhe nëse është e nevojshme dy komisioner.
- 11.4 Vendimet e asamblesë duhet të paraqiten në një procesverbal të firmosur nga presidenti dhe sekretari i; dhe në rastet e parashikuara me ligj, procesverbali duhet të redaktohet nga noteri.
- 11.5 Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e mbajtjes së asamblesë, certifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishëmve, irregullon zhvillimin e saj dhe certifikon rezultaten e votimeve.

### **Art. 12 – Vendimet e asamblesë**

- 12.1 Në thirrjen e parë asambleja ngrihet rregullisht me pjesmarjen e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqerisë së përmendur dhe merr vendime në shumicë unanime.
- 12.2 Në mbledhjen e dytë mbajtja e asamblesë është e vlefshme sado që të jetë pjesa e kapitalit të shoqërisë që disponojnë të pranishmit dhe merr vendime në bazë të shumicës së votave të të pranishmëve.
- 12.3 Për më tepër, mbi modifikimet e aktit të themelimit dhe mbi emërimin dhe fuqitë e likujduesve, asambleja mund të mbahet rregullisht dhe vendimet e saj të jenë të vlefshme qoftë në thirrjen e parë ashtu edhe në të dytën vetëm me prezencën e me shume se 75% të ortakëve dhe me votën pro të aq ortakëve sa të arrihet shumica e kapitalit të shoqërisë.

## **TITULLI IV ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

### **Art. 13 – Administrimi i shoqërisë**

- 13.1 Shoqëria administrohet, në varësi të asaj që vendoset herë pas here nga asambleja e ortakëve, nga një administrator i vetëm ose nga një këshil administrativ i përbërë nga dy ose pesë anëtarë, të emëruar edhe midis atyre të cilët nuk janë ortakë.
- 13.2 Administratori i shoqerise eshte Z.Gentian Nika, lindur ne Durres me 13/05/1987 me nr personal H80513066B.
- 13.3 Kohëzgjatja në detyrë e administratorëve do të përcaktohet nga ortakët në aktin e emërimit



administrativ përcaktohen nga ortakër.

13.4 Administratorit të vetëm ose anëtarëve të këshillit administrativ, u takon gjithashtu edhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsyet detyrës së tyre.

13.5 Shperblimi i administratorëve të veshur me detyra të posacme, dhe gjithsesi të ndonjë administratori të deleguar, përcaktohet nga këshilli administrativ.

#### **Art. 14 – Presidenti, zëvendës presidenti dhe administratori i deleguar**

14.1 Në rastin e emërimit të një këshillli administrativ, nëse nuk e kanë bërë ortakët, ky i fundit zgjedh midis anëtarëve të tij presidentin, zv.presidentin i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pamundësie të tij me fuqitë dhe kufizimet të përcaktuar kohë pas kohe nga këshilli administrativ.

#### **Art. 15 – Vendimet e këshilit administrativ**

15.1 Vendimet e këshillit administrativ merren me mbledhje kolegiale.

15.2 Vota nuk mund të jepet përmes përfaqësimit.

#### **Art. 16 – Mbledhja kolegiale e ëshillit administrativ.**

16.1 Këshilli administrativ do të mblidhet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër në Shqipëri ose jashtë, cdo herë që presidenti do ta quajë të nevojshme dhe kur do të kërkohet me shkrim nga të paktën dy prej anëtarëve të tij ose nga organi i kontrollit nëse kemi një të tillë të emëruar.

16.2 Si rregull thirrja do të bëhet përmes lajmërimit me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë që mund të provohet marrja e kësaj thirrje përmes atij sistemi, këshilltarëve të paktën shtatë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen me përjashtim rasteve urgjente kur lajmërimi duhet të dërgohet të paktën tre ditë para mbledhjes.

Në të njëjtat terma lajmërohen edhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar.

16.3 Këshilli administrativ mund të mbahet irregullisht dhe të quhet akt vendimmarrës edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpërmendura, nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe anëtarët e oranit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar, pa anashkaluar të drejtën e secilit pjesmarrës për të kundërshtuar diskutimin e argumenteve mbi të cilat konsideron se nuk është informuar mjafueshëm.

16.4 Mbledhja mund të mbahet edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarrjes si më poshtë: duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm të paktën presidenti dhe sekretari i mbledhjes, duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje, duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuarë si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistencë reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

16.5 Mënyra e deklarimit të votës nuk duhet të anashkalojë faktin se në cdo rast duhet të jenë mënyra që lejojnë evidentimin e atyre që japid vota kundër ose abstenojnë, vendoset me shumicën absolute të votave të të pranishëmve.

#### **Art. 17 – Vendime të marra me mbledhje kolegiale**

17.1 Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve

të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e presidentit për sa kohë këshilli të përbëhet prej më shumë se dy anëtarëve.

17.2 Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posacëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

### **Art. 18 – Fuqitë e organit administrative**

18.1 Organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administratorit, me përjashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca eksluzive të vendimeve të ortakëve.

18.2 Këshilli i administratorit ose administratori i vetëm do të ketë pra, ndër të tjera, të drejtën për të blerë, shkëmbyer, shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme, automjete, ti përfshijë në shoqëri, të marrë aksione dhe interesa, të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh, drejtore e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë.

18.3 Në rastin kur shoqëria administrohet nga një këshill, këshilli mund të delegojë një pjesë ose të gjithë atributet dhe fuqitë e tij dhe ato të presidentit, përfshirë edhe firmën e shoqërisë, njërit ose më shumë prej anëtarëve të tij duke mirëpërcaktuar atributet ose penalitetet si edhe shpërblimet në kufijtë dhe format që ai do ta gjykojë të përshtatshme.

### **Art. 19 – Firma dha përfaqësimi i shoqërisë**

19.1 Përvec rasteve të parashikuar në artikullin e mëparshëm 18.3, firma dha përfaqësimi i shoqërisë i takojnë administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit administrativ.

## **TITULLI V ORGANI I KONTROLLIT**

### **Art. 20 – Organi i kontrollit.**

20.1 Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet dhe të kryhet sipas zgjedhjes dhe me vendim të pronarëve nga një ekspert kontabël.

## **TITULLI VI BILANCI – FITIMET**

### **Art. 21 – Ushtrimi i shoqërisë , bilanci dhe fitimet.**

21.1 Ushtrimet e shoqërisë mbyllen më 31 ( tridhjetë e një ) dhjetor të cdo viti. Ushtrimi i parë mbylljet më 31 ( tridhjetë e një ) dhjetor 2022 ( dymijë e njezetedy ).

21.2 Bilanci i hartuar në konformitet me normat e patjetërsuara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të 31 Marsit të cdo viti, përvec mundësive kur mund të ketë një afat më të gjatë brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

21.3 Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen kështu :

- te ardhurat neto te shoqerise (fitimi) do te ndahen midis ortakeve ne menyre proporcionale me kuotat perkatese qe ata disponojne.

- fitimi i mbetur do të shpërndahet ose do të lihetmënjanë në varësi të vendimeve të ortakëve që aprovojnë bilancin.

Në cdo rast , nesë verifikohet humbje kapitali , nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të riintegrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

## **TITULLI VII** **SHKRIRJA, PËRJASHTIMI I ORTAKËVE, LIKUJDIMI DHE MOSMARRVESHJET**


### **Art. 22 – Shkrirja**

22.1 Shoqëria quhet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

22.2 Në cdo rast shkrirje të shoqërisë , ortakët do të përcaktojnë një ose më shumë likujdues dhe do caktojnë fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

### **Art. 23 – Dispozita të përgjithshme**


23.1 Për gjithcka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin e themelimit ose në këtë statut , do të bëhet kohë pas kohe një referim i shprehur i ligjeve në fuqi.

GENTIANA LIKAJ  


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER FLORIAN F. HOXHA



DATE 22/02/2021  
NR REP 222



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 22.02. 2021(Dymije e njezet e nje) , para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Gentian Nika, atësia Gjergj, amësia Margarita, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rr.Dalip Peza Lagja 17; Nd. Nr 884; Durrës; Durrës; 2006; Durrës, lindur më 13/05/1978, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031347329 dhe nr. personal H80513066B.

shtetasi i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruajti përpara meje Noter, "Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise NOE SHPK , bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, me ane te mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

FLORIAN F. HOXHA